  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....	.....
Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës.....	.....
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve .....	.....
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....	.....
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial .....	.....
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	.....
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit .....	.....
Shtojca 7. Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....	.....
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit .....	.....
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....	.....
<a href="#">Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak).....</a>	.....
<a href="#">Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)</a>	.....
<a href="#">Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)</a>	.....
<a href="#">Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)</a>	.....

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

---

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

## Shtojca 1/1.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet* ]

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sçarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;



4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

**d)** Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Norma e fitimit</b>

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					

---

<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> <b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

ARTIKULLI/ ARTICOLO	PERSHKRIMET/SPERCFIKIMET TEKNIKE DESCRIZIONE /SPECIFICHE TECNICHE	NJESI MATESE/ UNITA' DI MISURA	SASIA/ QUANTITA'
Tavoline	Tavolina përbëhet nga elementë me përmasa:  a) Tavolina e punës 130 × 70 × 75 cm  Tavolina e punës përbëhet nga suprina prej materiali Melamine/Mdf me trashësi jo me te vogel se 25 mm. Skeleti i tavolinës së punës bëhet nga melaminë me trashësi minimumi 18 mm. Ne pjesen ballore te tavolines eshte nje element lidhes i dy kembeve anesore per te krijuar shtangesi te skeletit. Materiali i elementit lidhes behet nga i njejti material si i kembeve anesore. Bashkimi i elementëve të tavolinës së punës bëhet me aksesore të	Cope	1

	pa dukshëm. Tavolina e punës mbështetet mbi kembeza plastike.		
Dollap	<p>Dollap dykanata me celes. Përmasat: jo më pak se 90x45xh220 cm.</p> <p>Materiali i perdorur do te jete melamine me trashesi jo me te vogel se 18 mm, bordet anesore te se cilit jane te veshura me material plastik pvc me spesor jo me te vogel se 1 mm.</p> <p>Pjesa e pasme e dollapit është e përbërë me fibër me trashësi jo më pak se 3 mm.</p> <p>Dollapi ka 2 kanata me hapje 90°, doreze e brave me çelës. I gjithë dollapi mbështetet mbi xokul me lartësi 6 cm.</p> <p>Pjesa e brendshme e dollapit do te ndahet ne 6 hapesira te barabarta me ane te 5 sergjenave melamine 25 mm.</p> <p>Lart dhe poshtë do të ketë shula për fiksimin e kanateve.</p> <p>Ngjyra percaktohet ne kushtet e lidhjes se kontrates.</p>	Cope	2
Karrige statike	<p>Karrige statike. Karriget të jenë dizenuara me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval jo me te vogel se 30 x15 mm, me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektostatike në temperaturë 240°C. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja jane material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Ne krahun e djathte te kene nje tavoline te palosshme prej plastik per te mbajtur shenime</p> <p>Montohen në skelet metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof cilësor ose lëkurë ekologjike.</p>	Cope	60
Projektor	<p>Teknologjia projektuese: DLP</p> <p>Rezolucioni i projektorit: 1024x768</p> <p>Rezolucioni maksimal: 1024x768 pixels</p> <p>Shkalla e kontrastit: min 20000:1</p>	Cope	1

	<p>Fuqia e llampës (W): min 3500 W</p> <p>Jetëgjatësia e dritës (economic mode): min4000 h</p> <p>Perde e bardhe e mbledhshme per projektim</p>		
Perde projektori	<p>Perde elektrike me pult 2.4 x 1.35 m Bracket</p> <p>Premium Deluxe Electric Projection Screen 108/16:9</p>	Cope	1
Sirtariere	<p>Përmasat e komedines (gjerësi x thellësi x lartësi): 45 x 53 x 60 cm lartësi (së bashku me rrotat) Struktura e sirtarierës të jetë melaminë me trashësi 16 mm deri 18 mm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishetjeve dhe njollave. Syprina dhe kapaket ballore të sirtareve duhet të jenë prej material melaminë me spesor jo me te vogel se 1.8cm. Bordet anësore, fiankeve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Sirtariera duhet të ketë 4(kater) rrota sferike në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtari i parë nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 3(tre) sirtarë të barabartë. Dy prej sirtarëve duhet të jenë të paisur me çelës. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës.</p> <p>Duhet te jene ne ngjyren e tavoliave (druri)</p>	Cope	12
Karrige statike	<p>Karrige statike. Karriget të jenë dizenuara me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval jo me te vogel se 30 x15 mm, me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektostatike në temperaturë 240°C. Në pjesën e brendshme me një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja jane material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni.</p> <p>Montohen në skelet metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof cilësor ose lëkurë ekologjike.</p>	Cope	3
Tavoline me gjatesi 140 me gjeresi 140 cm	<p>Tavoline me gjatesi 140 me gjeresi 140 cm me ndarje ne mes dhe lartesi 70 cm me bazament dhe kemb hekuri</p>	Cope	6



<p>me ndarje ne mes dhe lartesi 70 cm me bazament dhe kembe hekuri</p>	<p>Materiali i perdorur do te jete melamine ngjyre druri me trashesi jo me te vogel se 18 mm, bordet anesore te se cilit jane te veshura me material plastik pvc me spesor jo me te vogel se 1 mm.</p>		
<p>Karrige per zyra rrotulluese</p>	<p>Karrige per zyra rrotulluese,  Pjesa mbeshtetese eshte e lakuar e cila je jep mbeshtetjen e persosur per te evituar dhimbjet e shpines nga pozicioni qe ne zakonisht mbajme.  Lartesia eshte lehtesisht e rregullueshme.  Pjesa mbeshteteses te jete rrjete dhe ndenjsa material lekure. Ngjyre e zeze.</p>	<p>Cope</p>	<p>12</p>

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

**Sasia e mallit që kërkohet:** sipas tabelës se mëposhtme

**Afatet e lëvrimit:** brenda 60 diteve nga data e nënshkrimit të kontratës

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
Tavoline	<p>Tavolina përbëhet nga elementë me përmasa:</p> <p>a) Tavolina e punës 130 × 70 × 75 cm</p> <p>Tavolina e punës përbëhet nga suprina prej materiali Melamine/Mdf me trashësi jo më të vogël se 25 mm. Skeleti i tavolinës së punës bëhet nga melaminë me trashësi minimumi 18 mm. Në pjesën ballë të tavolinës është një element lidhës i dy këmbëve anësore për të krijuar shtangesi të skeletit. Materiali i elementit lidhës bëhet nga i njëjti material si i këmbëve anësore. Bashkimi i elementëve të tavolinës së punës bëhet me aksesore të pa dukshëm. Tavolina e punës</p>	1	Rruga Don Bosko ish parku i autobusave Tirane	Brenda 60 diteve nga nënshkrimi i kontratës

	mbështetet mbi kembeza plastike.			
Dollap	<p>Dollap dykanata me celes. Përmasat: jo më pak se 90x45xh220 cm.</p> <p>Materiali i perdorur do te jete melamine me trashesi jo me te vogel se 18 mm, bordet anesore te se cilit jane te veshura me material plastik pvc me spesor jo me te vogel se 1 mm.</p> <p>Pjesa e pasme e dollapit është e përbërë me fibër me trashësi jo më pak se 3 mm.</p> <p>Dollapi ka 2 kanata me hapje 90°, doreze e brave me çelës. I gjithë dollapi mbështetet mbi xokul me lartësi 6 cm.</p> <p>Pjesa e brendshme e dollapit do te ndahet ne 6 hapësira te barabarta me ane te 5 sergjenave melamine 25 mm.</p> <p>Lart dhe poshtë do të ketë shula për fiksimin e kanateve.</p> <p>Ngjyra percaktohet ne kushtet e lidhjes se kontrates.</p>	2	Rruga Don Bosko ish parku i autobusave Tirane	Brenda 60 diteve nga nenshkrimi i kontrates
Karrige statike	<p>Karrige statike. Karriget të jenë dizenuara me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval jo me te vogel se</p> <p>30 x15 mm, me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lysterje elektostatike në temperaturë 240°C. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i</p>	60	Rruga Don Bosko ish parku i autobusave Tirane	Brenda 60 diteve nga nenshkrimi i kontrates

	<p>cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Në krahun e djathtë të këmbës të palosshme prej plastik për të mbajtur shenime</p> <p>Montohen në skelet metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof cilësor ose lëkurë ekologjike.</p>			
Projektor	<p>Teknologjia projektuese: DLP</p> <p>Rezolucioni i projektorit: 1024x768</p> <p>Rezolucioni maksimal: 1024x768 pixels</p> <p>Shkalla e kontrastit: min 20000:1</p> <p>Fuqia e llampës (W): min 3500 W</p> <p>Jetëgjatësia e dritës (economic mode): min4000 h</p> <p>Perde e bardhe e mbledhshme për projektim</p>	1	Rruga Don Bosko ish parku i autobusave Tirane	Brenda 60 diteve nga nënshkrimi i kontratës
Perde projektori	<p>Perde elektrike me pult 2.4 x 1.35 m Bracket</p> <p>Premium Deluxe Electric Projection Screen 108/16:9</p>	1	Rruga Don Bosko ish parku i autobusave Tirane	Brenda 60 diteve nga nënshkrimi i kontratës
Sirtariere	<p>Përmasat e komedines (gjerësi x thellësi x lartësi): 45 x 53 x 60 cm lartësi (së bashku me rrotat)</p> <p>Struktura e sirtarierës të jetë</p>	12	Rruga Don Bosko ish parku i autobusave Tirane	Brenda 60 diteve nga nënshkrimi i kontratës

	<p>melaminë me trashësi 16 mm deri 18 mm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Syprina dhe kapaket ballore të sirtareve duhet të jenë prej material melaminë me spesor jo me te vogel se 1.8cm. Bordet anësore, fiankeve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Sirtariera duhet të ketë 4(kater) rrota sferike në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtari i parë nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 3(tre) sirtarë të barabartë. Dy prej sirtarëve duhet të jenë të paisur me çelës. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës.</p> <p>Duhet te jene ne ngjyren e tavoliave (druri)</p>			
Karrige statike	<p>Karrige statike. Karriget të jenë dizenuara me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval jo me te vogel se</p> <p>30 x15 mm, me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lysterje elektrostatische në temperaturë 240°C. Në pjesën e brendshme me një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja jane material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni.</p>	3	Rruga Don Bosko ish parku i autobusave Tirane	Brenda 60 diteve nga nenshkrimi i kontrates

	Montohen në skelet metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof cilësor ose lëkurë ekologjike.			
Tavoline me gjatesi 140 me gjeresi 140 cm me ndarje ne mes dhe lartesi 70 cm me bazament dhe kemb hekuri	Tavoline me gjatesi 140 me gjeresi 140 cm me ndarje ne mes dhe lartesi 70 cm me bazament dhe kemb hekuri  Materiali i perdorur do te jete melamine ngjyre druri me trashesi jo me te vogel se 18 mm, bordet anesore te se cilit jane te veshura me material plastik pvc me spesor jo me te vogel se 1 mm.	6	Rruga Don Bosko ish parku i autobusave Tirane	Brenda 60 diteve nga nenshkrimi i kontrates
Karrige per zyra rrotulluese	Karrige per zyra rrotulluese,  Pjesa mbeshtetese eshte e lakuar e cila je jep mbeshtetjen e persosur per te evituar dhimbjet e shpines nga pozicioni qe ne zakonisht mbajme.  Lartesia eshte lehtesisht e rregullueshme.  Pjesa mbeshteteses te jete rrjete dhe ndenjsa material lekure. Ngjyre e zeze.	12	Rruga Don Bosko ish parku i autobusave Tirane	Brenda 60 diteve nga nenshkrimi i kontrates

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 8 Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.



---

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 10 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

## **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta**

**2.4.1.** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001: 2015 në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent. Certifikata duhet të jetë e vlefshme.

**2.4.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar dhe Katalog Origjinal për produktet e ofruara i cili të ketë karakteristikat teknike në përputhje me specifikimet teknike.

Ne cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin për ofrimin e pajisjeve objekt të kësaj procedure. Autorizimi nga Prodhuesi duhet të përmbajë kontaktet e plota të prodhuesit (adresë, telefon, e-mail) në rast verifikimi.

**2.4.3.** Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë se merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit, si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve objekt prokurimi dhe se ofron garanci për mallat objekt prokurimi për një periudhë 1-vjeçare të garancisë nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, transportimin, mirëmbajtjen, zëvendësimin dhe shërbimin pa pagesë të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

**2.4.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi.

Sa më sipër mjeti nevojitet të jetë i pajisur me :

- a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

---

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje, e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës dhe garancisë

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- a) Kontratë qiraje, e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës dhe garancisë
- b) Leje qarkullimi e mjetit.
- c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
- ç) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**2.4.5.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi/qira ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi .

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje, e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës dhe garancisë

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje, e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës dhe garancisë

---

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë ambjentin që disponojnë sipas tabelës së mëposhtme

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

---

**Shtojca 8**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
